



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 34

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Prishtinë, më 13 korrik 2016, në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka dhe Mirjeta Kalludra,

Munguan: Besa Baftiu, Adem Hoxha, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Të ftuar: Imet Rrahmani, ministër i Mistrisë së Shëndetësisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardian Mehmetaj, UD- Sekretar i Mistrisë së Shëndetësisë, Ramadan Halimi, këshilltar - MSH, Musa Rexhaj - Ministria e Shëndetësisë, Bekim Fusha - Ministria e Shëndetësisë, Ukë Gashi – ZPRK, KOMF, KAADC dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 22.06.2016;
3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:
 - Marrëveshja e kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK;
 - Diskutim lidhur me punësimin e asistentëve dhe specialistëve të mjekësisë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent.

5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshim. Pika tre e rendit të ditës zhvendoset si pika dy, për arsye që të lirojmë ministrin me kohë pasi që ka angazhime.

2. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani:

Marrëveshja e kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK

Kryetarja e përshëndeti ministrin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë. Ju faleminderit zoti ministër që keni gjetur kohë me Kabinetin tuaj që të vini dhe ne kemi kërkuar nga ju që të njoftohemi në lidhje me marrëveshjen për kredi të “UNI Bank Austria” dhe financimin Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK. Domethënë, është i njëjti projekt dhe duhet të votohet, kjo ishte pyetja e dytë për të kaluar pastaj edhe në një problem që është shumë aktual e që është çështja e specializimeve, të punësimit të specialistëve ose asistentëve. Po në përgjithësi të specialistëve. Atëherë, që të mos humbim kohë, urdhëroni. z. ministër!

Imet Rrahmani, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë: Faleminderit, e nderuara kryetare!

Të nderuar deputetë,

Siç e dini kjo marrëveshje e kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK, pra për blerjen e aparaturës dhe modernizimin e shërbimit të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë ka qenë temë diskutimi edhe këtu në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Dhe, fatkeqësisht, kjo ka ndodhur pas mos ratifikimit nga ana e Kuvendit. Unë besoj që atëherë kemi qenë shumë të qartë dhe në detaje e kemi shpjeguar pse ka qenë e nevojshme kjo të kalojë në Kuvend dhe të arrihet marrëveshja dhe të fillojmë me procedurat e përmbushjes së kontratës të nënshkruar në prani të dy presidentëve. Sepse, kemi të bëjmë me dy shërbime shumë të rëndësishme të sistemit tonë shëndetësor dhe me nevoja të shumta të qytetarëve të Kosovës për marrjen e shërbimeve kardiologjike dhe të kardiokirurgjisë.

Sot, pas disa muajve, ne po e kthejmë këtë temë këtu, sepse Qeveria e Kosovës ka riproceduar në Kuvendin e Kosovës përsëri mundësinë e ratifikimit të kësaj marrëveshje dhe procedimi tutje të blerjes së aparaturës për modernizimin e këtyre dy shërbimeve.

Po ju informoj se kardiokirurgjia që nga tetori i vitit të kaluar është duke funksionuar si klinikë e veçantë, bëhen aty intervenime dhe tash janë tejkaluar të gjitha parashikimet për numrin e operacioneve a mund të bëhen brenda vitit në këtë klinikë, flasim për mbi 100 operacione për nga periudha e tetorit.

Në anën tjetër, në kardiologjinë invazive kemi të bëjmë me një situatë pak më ndryshe, përkundër numrit të madh të intervenimeve që bëhen në raste emergjente dhe jo emergjente, aparatura e cila është aktualisht në shfrytëzim është shumë e vjetër dhe për çdo ditë punëtorët shëndetësorë kanë probleme në dhënien e shërbimeve cilësore në lëmin e kardiologjisë invazive, sepse kemi thënë

edhe atëherë e kemi thënë edhe në Kuvend, e kemi thënë edhe gjithkund, është një aparaturë shumë e vjetër, është një aparaturë shumë e përdorur edhe me kapacitetet që ka nuk mund t'i përmbush nevojat e pacientëve tonë dhe për këtë arsye ne jemi të detyruar që numër të madh të pacientëve t'i trajtojmë jashtë institucioneve tona publike, respektivisht në institucionet private dhe kjo buxhetit të Kosovës po i kushton mjaft shumë kur dihet që stentimet dhe by pass-et sillen nga 5 mijë deri në 10 mijë, ndoshta edhe më shumë në institucionet private.

Buxheti për trajtim jashtë vendit nuk po mund t'i përballojë. Kjo marrëveshje mund të them që ka ardhur pa asnjë ndryshim nga hera e parë dhe ju ftoj që të gjejmë mirëkuptim dhe kjo të merr votat e duhura në Parlamentin e Kosovës në mënyrë që të procedojmë tutje në blerjen e aparaturës dhe krijimin e kushteve më të mira për dhënien e këtyre shërbimeve në QKUK, respektivisht në Klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiokirurgji.

Unë nuk kisha me shtuar më shumë për fillim.

Kryetarja: Një pyetje. Ndoshta edhe kolegët e mi kanë pyetje. Atëherë, marrëveshja është refuzuar për shkak të çmimit jo konkurrent ose çmimit të fryrë që na është dukur se për këtë arsye, se ju e dini më mirë shkakun pse është refuzuar nga deputetët se s'kishte mjaft sqarime që ata të binden se duhet ta votojnë, përveç nevojës domethënë ishte çështja e çmimit kjo.

Dhe, prandaj tani që vjen pa ndryshime kjo marrëveshje atëherë cili është arsyetimi nga ana juaj që ne duhet të ratifikojmë këtë marrëveshje.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Faleminderit! Ne e kemi analizuar dhe mendojmë se nuk ka pas nevojë të bëhen ndryshime, sepse janë respektuar të gjitha procedurat, të cilat parasheh marrëveshja mes Ministrisë së Financave të Kosovës dhe Ministrisë së Financave të Austrisë kur është lidhur në vitin 2012 për 20 milionë euro kredi dhe çmimi që ka ardhur prej 2.6 milionë euro është çmim që parasheh pjesën shtesë e cila është dashur t'i nënshtrohet dhe ju ka nënshtuar vlerësimit juridik, pjesa shtesë është diku rreth 500 mijë euro, tash saktë shënimet me euro nuk i kam.

Dhe, kjo pjesë shtesë ka paraparë: trajnimin e stafit dy javë në klinikat e Austrisë, ka paraparë mirëmbajtjen shtesë dhe për një vit në raport me kontratën që është paraparë në 2.1 milionë, ka paraparë krijimin e kushteve të përshtatshme për instalim të aparaturës, rregullimin e ambienteve, izolimin, meremetimin dhe vendosjen. Do të thotë, krejt kjo është vlerë shtesë për të shtuar edhe një vit mirëmbajtje dhe servisim për aparaturat që kemi pas t'i blejmë, me bërë në vend një ditë trajnim për stafin brenda dy javë në Austri dhe me i rregulluar ambientet për me vendos aparatin, sepse kemi të bëjmë me një aparat që është edhe i madh, edhe i rëndë, edhe nuk është bash i pa rrezikshëm nëse përdorim në ambiente jo standarde.

Dhe, për këtë arsye ne nuk kemi menduar dhe e kemi vlerësuar që nuk ka arsye të bëhen ndryshime, sepse marrëveshja është e tillë dhe si e tillë ne mendojmë që duhet ta ratifikojmë dhe të shkojmë tutje.

Kryetarja: A ka dikush nga deputetët, urdhëro!

Hatim Baxhaku: Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit zoti ministër,

Unë edhe atëherë kam qenë për këtë me ratifikuar këtë marrëveshje në Kuvend edhe sot ndaj të njëjtin mendim dhe sa i përket dyshimeve në vlerat e pengesës në çmimet e aparaturës e cila është

blerë edhe atëherë kam thënë që sigurisht Austria ka standarde tjera nga standardet tona për blerjen e aparaturës. Unë jam një mjek i cili përditë punoj në spital, domethënë nuk jam një njeri që nuk di, nuk njihem me përditshmërinë dhe problemet më të mëdha nëpër spitale mund t'i pyetni drejtorët dhe të gjithë ekspertët, problemet më të mëdha janë blerja e aparaturës së re pa standarde të Kinës, tash nuk po dua të përmend shtete, po aparaturat, të cilat nuk kanë qëndrueshmëri dhe pas një viti shkatërrohen, nuk funksionojnë, nuk punojnë, po ashtu nuk kanë edhe të gjithë parametrat sipas standardeve, të cilat kërkojnë sipas standardeve.

Unë nuk dua të dyshoj që në qoftë se ju keni thënë që edhe tenderin e ka dhënë Austria, apo...

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Krejt procedurat janë bërë atje.

Hatim Baxhaku: Nuk duhet të dyshojmë që aty ka ndonjë keqpërdorim të parasë. Unë besoj që qëllimi kryesor ka qenë blerja e aparaturës së mirë, aparaturës e cila do të ketë një qëndrueshmëri më të gjatë, prishje më pak dhe do të jep rezultate më të mira.

Edhe atëherë është shfaq ky dyshimi për 500 mijë euro, pse është 500 mijë euro më kredia se sa vlera e tenderit dhe pas shpjegimit që i dhatë... Ministri edhe sot, unë mendoj që nuk është ndonjë vlerë e madhe 500 euro për edhe një vjet shtesë për një trajnim dy javor të stafit dhe rregullimit të ambientit, përshtatshmërisë së ambientit për vendosjen e këtyre aparaturave.

Prandaj, unë atëherë kam qenë për dhe unë besoj që edhe anëtarët e komisionit, por edhe deputetë duhet të jenë pro kësaj marrëveshje. Faleminderit!

Bekim Haxhiu: Faleminderit, kryetare!

I nderuar ministër,

Edhe stafi i ministrit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim kur ka ardhur kjo marrëveshje në momentin që është analizuar si marrëveshje, fillimisht dua të shpreh mirënjohjen time për Qeverinë e Austrisë për përkrahjen dhe mbështetjen në veçanti në shëndetësi, ku marrëveshja prej 20 milionë euro e kredisë parashihte investimet në shëndetësi për prioritet në shëndetësi se a është duke ia qëlluar Ministria me këto investime në prioritet, të gjithë këtu që jemi prezentë jemi dëshmitarë për aferën në këtë sferë të shëndetësisë se a është prioritet investiv kur vetëm e rikujtojmë, më 16.03.2013, për herë të parë është inauguruar kardiokirurgjia nga ministri Agani, dhe për herë të dytë është inauguruar i njëjti shërbim, në tetorin e vitit të kaluar nga ministri Rrahmani dhe deri më tani janë kryer afro 100 operacione aty. Po sa është numri i operacioneve pas hapjes së këtij shërbimi në spitalet private do të ishte mirë të na jepni një llogari nga ministri, për arsye se ne po hapim një shërbim, po investojmë dhe nëse e krahasojmë investimet në kardiokirurgji dhe kardiologji invazive prej fillimit janë 5 milionë e 200 mijë euro në kardiokirurgji të investuara më herët, janë afro mbi 1 milion e 600 mijë të investuar në kardiologjinë invazive më herët që përafërsisht kapin shumën për 7 milionë euro të investimeve në investime në këtë fushë dhe prapë kemi pasur referime të pacientëve jashtë institucionit publik që është në kundërshtim me Ligjin e shëndetësisë.

Momentin që një shërbim hapet në institucionin publik referimi i pacientëve pastaj në institucionet private dhe jashtë vendit është i kundërligjshëm dhe ky ka qenë një nga vërejtjet e mia, por prapë ne po duam të investojmë në këtë shërbim, ashtu si ka thënë ministri në mbledhjen e kaluar për këtë temë këtu në komision që po blejmë aparaturë rezervë dhe në Kuvend kam thënë që po blejmë aparaturë rezervë për arsye se aparaturë e tillë ekziston në Qendrën Klinike Universitare. Prandaj pasi është kthyer ky projektligj edhe njëherë në Kuvend, të paktën është dashur t'i ndryshohet emri,

mos të jetë “modernizim i aparaturës, i kardiologjisë invazive”, por të ishte “blerja e aparaturës rezervë për kardiologjinë invazive” për arsye se aparaturë e tillë veç ekziston.

Sido që të jetë ka ardhur në këtë formë që ka ardhur, ministri prapë nuk e arsyetoi rritjen e kredisë për 500 mijë euro për arsye se kjo është pjesë e dokumentacionit të dosjes së tenderit dhe në artikullin 18, është inspektimi, domethënë si pjesë obligimeve të operatorëve që kanë paraparë të konkurrojnë për këtë projekt dhe që kanë ofruar. Inspektimi ka qenë detyrë e detyrave projektuese dhe tenderuese. Instalimi i kësaj aparature dhe trajnimi.

Pra, nëse është pjesë e tenderit dhe e çmimit tenderues pranimit, instalimi i aparaturës dhe mirëmbajtja e saj, e që besoj që ministri e dinë shumë mirë se kontratën e ka në zyrë dhe e dinë që kjo pjesa e trajnimit ka qenë pjesë e tenderit. Pse është rritur kredia për 500 mijë euro? Në një emision televiziv që kemi qenë bashkë me ministrin ka thënë që është për izolimin e hapësirës dhe lyerjen e hapësirës ku ka me u vendosur. Ne gjithë e dimë që kjo aparaturë vendoset në 100 metra katrorë maksimum 150 metra katror dhe nëse 150 metra katror kushtojnë me u lye dhe izoluar 500 mijë euro, sido që të jetë edhe këtë çmim do ta pranoni nëse e kanë projektuar dhe udhëhequr institucione kredibile ndërkombëtare, por do ta pranoni pasi edhe ky 500 mijë euro që kanë me paguar tatimpaguesit kosovarë do të kalonte procedurën tenderuese.

Duhet të dimë se po aprovoni një shkelje ligjore me votën tonë dhe nuk do lejojmë që të abuzohen 500 mijë euro pa tender të fryra në këtë formë, derisa nuk ka një arsyeshmëri formën se pse është rritur kredia për 500 mijë euro. Në parim e mbështesim çdo investim parimisht, por kur ajo të jetë në mënyrë ligjore e arsyetuar dhe e argumentuar. Sa i përket politikave të këtij ministri dhe ministrit të kaluar, as me atë të kaluarin s’jam pajtuar, por s’pajtohem me këtë dhe të ministrit Rrahmani për arsye se janë politika programore jo të mira, jo në interesin e pacientit, por për interesa individuale dhe grupe, prandaj nuk e kam përkrahur as atë të kaluarit, as të këtij të tanishmit.

Kërkoj vërtet ministër që të jeni më azhur në këtë çështje, të arsyetoni edhe nëse është për dy javë ditë trajnim mi jep 500 mijë euro, të paktën kaloni në procedurë tenderuese, të paktën. Të paktën një procedurë konkurruese, për arsye se procedura konkurruese edhe pse ky proces është zhvilluar në Austri e dimë që ka qenë detyrim që prodhuesi të jetë austriak, por edhe në dosjen e tenderit që është e precizuar që emri apriori e projekton që “philipsi” të jetë kompania përzgjedhëse.

Do të thotë është bërë njëfarë në përgatitjen e dokumentacioneve që e ka përgatit Ministria e Shëndetësisë i ka dhënë orientimet e saj që kjo të specifikimet në numër të njëjtë do të thotë ka dhënë specifikimin që apriori është përcaktuar “philipsi”. Por, sido që të jetë ne edhe tani kur po e diskutojmë, kur ky tender është nënshkruar pothuajse do të bëhet gati edhe një vit tani e dimë që në treg edhe ka rënie të çmimeve të kësaj aparature të paktën për një 20%. Prandaj ta aprovoni edhe njëherë të njëjtën, ta aprovojme të njëjtën gjë pa arsyeshmërinë e 500 mijë eurove duke e pasur parasysh që çmimet në treg kanë rënë. Atëherë cila është arsyeja pse ne duhet ta votojmë një marrëveshje të tillë, kur ne kemi investuar në kardiokirurgji përafërsisht 7 milionë euro dhe prapë s’e kemi funksionale, kurse shpenzojmë në sektorin privat mbi 4 milionë e gjysmë euro a për shërbimet të cilat i kemi hap në sektorin publik cila është kjo politikë, vërtet s’e kam të qartë. Faleminderit!

Kryetarja: Faleminderit!

Zoti ministër, po e shihni që në komision jemi shumë të vetëdijshëm për rëndësinë e rritjes së nivelit të ofrimit të shërbimeve në kardiokirurgji, por po shihet se pse nuk është votuar kjo në Kuvend. Pra, kanë munguar shpjegimet e juaja më detaje dhe bindja e deputetëve se kjo kredi nuk ka pasur një problematikë brenda saj.

Dhe, kjo po kërkohet edhe në këtë takim që të na jepni domethënë dhe të bindemi pse ta votojmë kur e njëjta, për një arsye nuk është votuar ndoshta edhe gjatë kësaj kohe ndërmjet dy propozimeve të njëjta kanë qenë dashur vetë ministria të jetë më popullore dhe të jap më shumë shpjegime, më transparente.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: E nderuara kryetare!

Unë ju kam përgjigjur ftesës mu në këtë përbërje këtu dhe në këtë sallë, me përkushtim e kemi shpjeguar.

Unë e thashë edhe në fillim pas mos kalimit të Kuvend edhe dokumentacionin bazë e keni pasur në kopje fizike dhe elektronike, dhe kontratën dhe të gjitha. Kështu që për mos transparencë unë nuk kisha me thënë që mund të pajtohem. Mua më vjen mirë që deputeti një pjesë të shpjegimeve që i kemi marrë më herët i ka kuptuar dhe domethënë kemi qenë të qartë, sepse atëherë keni qenë kategorik që procedurat është dashur të bëhen në Kosovë, jo në Austri. Tash po e pranoni që sipas marrëveshjes është dashur të bëhen në Austri dhe ashtu kemi bërë dhe specifikacionet e aparaturës që është dashur të blihen, i kanë bërë ekspertët e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë.

Ekzistojnë edhe takimet e shumta që kanë bërë mu këta që sot janë kardiokirurgji dhe kardiologji dhe mbi bazën e atyre specifikacioneve ne edhe i kemi dërguar dokumentacionet dhe është hap tenderi, tenderi i cili është udhëhequr nga Agjencia Austriake për Shëndetësi dhe Inxhiniering.

Trajnimi në kontratën bazë është një ditë në Prishtinë, në klinikat këtu, ndërsa me shtesën është 2 javë në klinikat e Austrisë atje ku ka raste më shumë dhe ku mund të praktikohet përdorimi i kësaj aparature. Unë kisha me thënë që në kardiokirurgji është planifikuar të blihet një aparat ekstra korporal dhe ata që e dinë se sa është komplekse intervenimi në zemër të hapur dhe çfarë do të thotë aparati ekstra korporal mund ta kuptojnë drejtë se çka do të thotë ta kesh vetëm një aparat ekstrakorporal në klinikë dhe të futesh në operacion të zemrës së hapur dhe e dyta, aparati ekstra korporal është vendosur në lista nga ekspertët dhe vetëm ashtu ne kemi vendosur ta blejmë 4.6 milionë euro ka qenë i planifikuar në buxhet të vitit 2015, dhe dëmi është bërë mjaftueshëm për Ministrinë e Shëndetësisë, sepse 2.6 milionë euro nuk i kemi shfrytëzuar, por me këto 2 milionë euro të tjera që kemi pasur në plan të blejmë aparaturë. E treta, unë kam informatë që vetëm mirëmbajtja e aparaturës ekzistuese në kardiologji dhe 2-3 aparateve të tjera është ofertë tash se të kushtojë 720 mijë euro. Tash paramendoni, një vit shtesë për servisim, trajnim dy javor dhe izolimi dhe përgatitja e krejt hapësirave për shfrytëzim adekuat dhe krijimin e kushteve sigurta për funksionim a është vlerë e madhe a jo? Faleminderit!

Kryetarja: Faleminderit! Urdhëroni z. Haxhiu!

Bekim Haxhiu: Faleminderit! Profesione të kemi të gjithë edhe kush sa ka njohuri e vlerësojnë të tjerët. Po flasim për politikën shëndetësore këtu, si je menaxher i shëndetësisë, kryesori në Kosovë edhe po të ishe ndonjë ekspert i madh do të ishe duke punuar në klinikë.

Por, flasim për politikën shëndetësore 2015 në projektbuxhet ke planifikuar sallën hibride, nëse do vazhdoje të implementoje projektin e sallës hibride sigurisht fjala “modernizim” do të kishte vend. Por të blesh aparaturë rezervë dhe ta quajtsh “modernizim” atëherë që edhe u tha që ekziston veç është një në sallën e kardiokirurgjisë, po e blen të dytën. Pra, po e blen të dytën. Po blen aparaturë rezervë dhe e ke rrezikuar një projekt të madh të Austrisë për interesa individuale, grupe dhe të që është bërë nga ekspertët të fushës të cilët sot ndoshta janë edhe disa nga ata që kanë marrë pjesë në hartimin e dosjes së këtij tenderi bashkë me disa këshilltarë të juaj që sot i ke edhe prezentë këtu,

sigurisht që në procesverbale munden të vërehen edhe ato që është bërë kjo përgatitje edhe i është orientuar sigurisht që është bërë mirë që është organizuar tenderi në Austri dhe jo këtu. Por, unë asnjëherë nuk kam thënë që është dashur këtu të organizohet tenderi, nuk mundesh ta gjesh atë fjalë, prandaj mos thur gjëra të pavërteta, të cilat nuk janë thënë asnjëherë nga unë.

Kam thënë atëherë që është bërë mirë që është organizuar në Austri procedura e tenderimit, por përgatitja prej këtyre ekspertëve të huaj që i ke dhe atyre që në kardiokirurgji kanë bërë këtë përgatitje kanë bërë njëfarë orientimi që “Philipsi” paraprakisht të jetë fitues i këtij tenderi kur e kanë bërë në specifikimin numër një që emri i mbrojtur duhet të jetë ... por sido që të jetë i nderuar ministër, në Qendrën Klinike Universitare ekziston një kontratë e mirëmbajtjes së aparaturës që është valide edhe për aparaturën e kardiologjisë invazive edhe të kardiokirurgjisë në aparaturën në kuadër të SHSKUK-së.

Prandaj për mirëmbajtje nuk ke nevojë me i harxhuar 500 mijë euro ekstra, por edhe sikur nëse ke vendos mi shpenzuar 500 mijë euro ekstra nuk po flasim për 500 euro a 50 cent, po flasim për gjysmë milionë euro të taksapaguesve kosovarë që ne kemi me i paguar, nuk po na i fal askush dhe këto duhet t’i shpenzosh sipas procedurës domethënë dhe Ligjit për shfrytëzimin e parasë publike. Do të thotë edhe nëse do me e bërë trajnim dy javë ekstra duhesh me anë të procedurave tenderuese e jo pa procedurë tenderuese ta rritësh vlerën e kredisë prej 2 milionë e 100 mijë në 2 milionë e 600 mijë.

Nuk po flasim për pak para, por bajagi para, prandaj duhesh ta arsyetosh këtë që të na bindësh e deri tani nuk je duke arritur. Prandaj kjo marrëveshje në këtë formë as nuk duhet të na vijë dhe të na sfidojë sërish duke marrë parasysh se ka dështuar.

Kryetarja: Kur është fjala për huamarrjen, qofshin ato kritere të buta, sigurisht që duhet të jemi syhapur sepse Kosova gjithnjë nuk mund të hyjë në kredi vazhdimisht edhe të rëndohet buxheti sepse vjen një ditë kur do të kemi edhe për këtë përgjegjësi. Fjalën e ka kërkuar doktor Shaip Muja.

Shaip Muja: Faleminderit, zonja kryetare! Të nderuar kolegë! Unë jam i shqetësuar se kjo Qeveri duke mos ditur me menaxhuar punët e veta dhe obligimet mundohet me krijuar opinion publik se përgjegjësit e problemeve është Parlamenti, jo vetëm për këtë çështje që sot jemi mbledhur, por edhe për shumë çështje të tjera.

Unë reagoja, sepse metoda e ministrit për ata që s’e din me krijuar opinion publik çka po ndodh, ne së paku tre kirurgë jemi këtu. Nëse ti s’ke pasur shans me e pa si ministër, ne të tre e kemi parë edhe e dimë sa kushton, më e mira sa kushton edhe më e lira sa kushton edhe më optimalja sa kushton, si çmim. Prandaj, ju kisha lutur leksione morale për efekte politike mos mbani, sepse nga ne je votuar për t’u bërë ministër dhe neve na adresoni mandej, na lypni neve llogari në vend që ne juve me ju lyp llogari, ju ktheheni na lypni neve. Kjo është mbrapsht, t’u ndërtuar sistemi shtetëror, sistemi i funksionimit të krejt strukturës shtetërore, një problem është pa hyrë në detaje.

Çdo arsyeshmëri që ju e jepni, çdo kompani sot që ta shet një aparat të jep edhe trajnimin pa para. E ka brenda “including the price” thotë anglisht. Këto janë spekulime, e dyta neve na kanë ardhur disa përshkrime nga tri kompani prestigjioze për këto aparatura kur e kemi kthyer herën e kaluar dhe vlera varion nga 1 milion e 100 mijë dhe 1 milion e 210 mijë euro pa këtë pjesën. Çka ke me akomoduar një ambient ku ti ke me rregulluar aty, ku mund të kushtojë 100 mijë euro. Po e zëmë 1 milionë e 300 mijë euro, këtu po flitet për me ia huq për 1 milion e 300 mijë euro edhe atë huqje për 1 milion e 300 mijë euro duhet me filluar një auditim. Auditimi duhet, unë e kam thënë edhe në seancë plenare nëse e ke specifikimin teknik janë kompanitë publike, nëpër internet i ke, i ke

çmimet dhe nuk kemi ne nevojë me quajtur kredi, një diçka që nuk është favor as ekonomik, e as publik i Republikës së Kosovës.

Prandaj, në interesin publik është me pasur ne aparatura, me pas njerëz të përgatitur. Skandalet, të cilat i krijon Ministria e Shëndetësisë dhe po mundohet me i gjuajtur në QKUK, unë të kam adresuar shqetësime edhe buxhetit kur ia kemi marrë ... pa ligj. Këtu rrjedhin problemet, zonja kryetare, sepse centralizimi që po i bëhet shëndetësisë me dorë të fortë është instruksion edhe qëndrim edhe i Organizatës Botërore të Shëndetësisë edhe miqve tonë ndërkombëtarë edhe të gjithëve që Ministria e Shëndetësisë duhet të decentralizohet.

Kjo nuk është duke u decentralizuar, por është duke super centralizuar. Prandaj, këtu po rrjedhim problemet sikur ne jemi të paprekshëm, kemi të gjitha në dorë dhe ne dëmtojmë çfarë të duam. Në opinion publik të keni kujdes, ju kam ndjekur me vëmendje, e komentoni edhe Ligjin e shëndetësisë, komentoni reformat. Nëse ke guxim edhe aty ku unë e kam dërguar në Kushtetutë edhe thua “ajo është bërë gabim” ju vetë e keni shfrytëzuar atë ligj që e kam çuar unë në Kushtetutë, ju keni punuar edhe privat edhe publikisht, vetë si ministër para se me ardhur ministër.

Prandaj, ti duhesh me dhanë shpjegim logjik e jo publik duke e ditur që janë nja 2-3 vetë këtu që po bëjnë probleme, ndërsa 17 mijë punonjës shëndetësorë janë ata të cilët me këta 2-3 vetë po sillen, nuk është ashtu. Sepse, duhesh me iu akomoduar sistemit, kushteve duhet me iu akomoduar, e jo me u dhënë mjeteve të informimit.

Më keni kundërshtuar për mjetet e financimit të SKUSH-së që i keni marrë edhe kam thënë në seancë plenare që ju do të dilni, do të kërkon votat e Parlamentit. Unë e kam bërë këtë punë edhe ashtu e bërë. Sot kjo kredi nuk është problem i yni, nuk është problem, ky është problem publik që ka kaluar, informacione ka të mjaftueshme për specifikimin teknik. E ka trajnimin secila kompani vlera e tyre dihet sa kushton, sa kushtojnë të gjitha aparaturat. Ne mund të ua lejojmë operacionalizimin e fitimeve një kompanisë ose dy kompanive por nuk mund të themi 1 mijë % me fituar, le të fitojnë ata. Nuk po thotë kurrkush mos me fituar, sepse nuk jemi e dimë që është ekonomi e tregut, por jo nga diferenca nga 1 milion e 200 mijë në 2 milionë e 600 mijë, me qenë 1 milion e 300-400 mijë, me qenë një distancë jashtëzakonisht e madhe.

Qendra Klinike Universitare ka nevojë për rifreskim të aparaturave, ka nevojë për shtesë, për servisim më korrekt, ka nevojë më mirë kish qenë me u marr me një kredi për me privatizuar krejt servisimin, me privatizuar krejt servisimin si shërbim, siç janë disa, janë praktika të njohura këto se sa mu marrë me disa gjëra të cilat dihen sa kushtojnë vetëm në internet, këtu i ke krejt komplet aparaturat, i ke çmimin e tenderit në internet, kur të duash mundem me t'i nxjerr prej kësaj korporales që e përmend, prej një angiografit, angiografi më i miri që ekziston e deri te optimali.

Në Republikën e Kosovës ka nevojë optimal edhe mos me lejuar skandalet mandej. Ne kemi prodhuar skandal edhe me kardiokirurg, kardiokirurgët nuk kanë skandal me QKUK-në, kanë skandal me sistemin. Sistemi është dashur të përgjigjet për kardiokirurg, sepse ata nuk kanë pasur aparatura duke punuar, ata po përgjigjen sot pse s'po punon aparatura dhe kur nuk punon aparatura ata kanë pasur të drejtë me referuar diku se rrugës çka kanë folur ata është problem i tyre legal i evazionit fiskal, por nuk është i veprës së lartë penale i trajtimit të papërgjegjshëm ose i pandërgjegjshëm që quhet.

Prandaj, ne, duhet si shtet me i marr obligimet. Nëse unë nuk ia kam plotësuar kushtet me punuar kardiografi, angiografi me punuar 24 orë, kur vjen pacienti mua nuk më punon angiografi, nuk më punojnë stendat me ia ngjitur pacientëve. Tash ti nuk guxon me i kallëzuar edhe pacientit ku ka me

u trajtuar. Ne duhet me ju treguar sepse ne bëjmë vepër penale nëse punojmë me pacientë ku duhet me e vu, a në Prishtinë, a në Amerikë, a ku duhet me e vendos një stendë sepse aparati jonë shtetëror nuk ka për atë përgjegjësi, e ka Ministria e Shëndetësisë, e kanë strukturat udhëheqëse, se nuk e kanë monitoruar ose nuk e kanë verifikuar.

Në pikën tjetër është edhe njëjtë sot e keni temën edhe për problemet e specialistëve.

Kryetarja: Mandej do ta pyesim. Ka dikush nga ju që do me fol.

Hatim Baxhaku: Nuk jam këtu as avokat i ministrit, as i Qeverisë, por një send ne duhet të pajtohemi për një gjë këtu. A ka nevojë për këto aparatura a s'ka nevojë? Në qoftë se ekspertët në Qendrën Klinike Universitare kanë thënë që kanë nevojë për këtë aparaturë, atëherë s'kemi çka flasim më tutje.

Do të thotë, duhet kjo aparaturë. Shpesh për specifikat dhe çmimet unë nuk jam ekspertë sa kushtojnë, sa s'kushtojnë. Unë kam besim në atë kompaninë austriake që nuk ka bërë ndonjë keqpërdorim. Në spital ne kemi pasur në endoskopi tri lloje aparatesh: olimpus, shtos edhe filips. Spitalet rajonale ose Qendra Klinike sigurisht që do të shkojnë kah unifikimi i aparaturës, sepse duhet tri lloje mirëmbajtje kështu që unifikimi i aparaturës edhe ne i kemi pasur pesë lloje të aparateve për anestezië, pesë lloje të aparateve për anestezion dhe pesë kompani mandej me i mbajtur për servisim.

Kështu që edhe në qoftë se kompania ose qendra përcaktohet për një markë, unë nuk e shoh aq tragjike edhe këtë çështje, sepse ndërmarrja ose operatori shëndetësor, ose spitali rajonal i sheh edhe interesat e veta. Prandaj, unë mendoj që prapë po biem në konflikt, ne nuk mund ta presim që me u prishur aparatura dhe pastaj me prituri një vit tenderimi. Ç' tenderimi dhe me blerë. Në qoftë se ajo aparaturë është kah fundi dhe sipas ekspertëve është thënë që është nga fundi ose nuk funksionin ne patjetër duhet t'i blejmë.

Në qoftë se ajo aparaturë nuk funksionon për ditë, normalisht që do të çohet jashtë dhe nuk mundemi të akuzohemi pse po i çojmë jashtë, këto dy çështje janë kontradiktore. Në qoftë se s'kemi aparaturë sigurisht nuk funksionin duhet të çohen jashtë, në qoftë se kemi aparaturë dhe nuk nevojitet kjo është çështje tjetër, unë nuk po hy aty sepse nuk e di, besoj që ju sigurisht keni konsultuar Qendrën Klinike Universitare, Klinikën e Kardiologjisë Invazive dhe Kardiokirurgjisë dhe sigurisht ata kanë nevojë për këto aparatura, jam i bindur që kanë nevojë.

Prandaj, unë mendoj që edhe servisimi për një vit nuk është shumë, sepse ne e dimë që servisi, unë prapë po flas praktikisht, e thërrasim servisin në Prizren vjen edhe shkon thotë "s'mundem me bë kurrgjë vijmë pas dy jave". E çojnë dikë tjetër, vije kompani tjetër që e kontaktojnë prej Serbisë bile na sjellin. Kështu që në qoftë se ajo kompani është e thirrur dhe e trajnuar për servisim të këtyre aparaturave mendoj që ajo normalisht që kërkon të paguhet dhe nuk është ndonjë çmim ku me ditur çfarë në qoftë se nuk ka keqpërdorim. Në qoftë se s'kanë keqpërdorim pse është çmimi më i madh unë nuk jam kundër asaj, edhe në qoftë se për servisim dikush lyp 200 mijë e jo 50 mijë, por është ekspert dhe e kryen punën, unë jam për atë 200 mijë me dhënë, por jo me ia dhënë për dallavere se po bëhem pak banal.

Pra, në qoftë se çmimi i lartë është për shkak të kualitetit të aparaturës, dhe çmimi i lartë i servisimit është për shkak të përgjegjshmërisë dhe ekspertizës së kompanisë e cila e bën atë servisim, unë mendoj që nuk është çmimi i madh dhe nuk duhet të jetë çmimi problem për ta refuzuar. Faleminderit!

Kryetarja: Urdhëro, ministër!

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Faleminderit, kryetare!

Unë desha të them kështu që si të keni kohë komplet shkojmë në Qendrën Klinike Universitare sot në kardiologjinë invazive edhe e shohim çfarë situatë është gjendja me aparaturë dhe nëse ata thonë që ai aparat është funksional dhe ai aparat i përmbush kriteret e punës, edhe nuk nxehet te çdo i treti ose i katërti dhe me e tërheq pacientin nga salla, atëherë ne e tërheqim marrëveshjen.

Jo, zotëri kur të thoni që aparatura është, unë them që aparatura është, por është para bllokimit, para prishjes dhe operatorë... Unë ju dëgjova boll mirë, aparati koronarografi është para prishjes. Operatori i cili ka qenë i angazhuar për mirëmbajtje nuk e sheh të udhës me investuar më në atë aparat, sepse është aq i vjetruar, aq i konsumuar edhe nuk garanton vazhdimësi, kjo është një. Do të thotë, nevoja për aparaturë është më se e domosdoshme.

Nën dy, skadenca e kompanisë që e ka kontraktuar mirëmbajtjen ka përfunduar, ka skaduar kontrata nëse nuk e keni ditur, dhe mua për këtë oferta e re që ka ardhur, ka ardhur 700 e kusur mijë euro, që është më shumë se sa ofertat që e kemi këtu. Për procedurat sigurisht që mund të bëhet një komision i arbitrazhit në çfarëdo kohe dhe të vlerësohet se sa agjencia austriake për shëndetësi dhe inxhiniering i ka respektuar procedurat dhe ligjet konform marrëveshjes dhe konform procedurave standarde.

Çmimet nuk i cakton Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë ka shpallur interesin për me blerë, ka shpallur procedurat dhe ky është çmimi që ka fituar. Ne e kemi pas një nen atje që ka thënë oferta shtesë nëse vlerësohet si e paligjshme mund edhe të mos futet në kuadër të çmimit përgjithshëm. Por, kjo nuk është vlerësuar e tillë. Unë i nderuar deputet, kam respekt të madh në angazhimin e juaj gjithmonë në shëndetësi. Unë nuk mund ta di se si ndihen 2-3 vetë në shëndetësi kur ngritën problemet e mëdha që janë akumuluar me vite edhe absolut as unë, asnjë ministër kushdo tjetër për një vit nuk i zgjidh. Ka probleme të shumta që qoftë sistemi, qoftë rrethanat kosovare i kanë sjellë në këtë situatë dhe ne kemi probleme të shumta, të cilat duhet t'i zgjedhim bashkarish, por asnjëherë nuk ju kemi drejtuar opinionit me tendencë që ta shantazhojmë ose ta manipulojmë, përkundrazi kemi qenë ndoshta për herë të parë një nga ministrat që në thjeshtësinë dhe korrektësinë më të madhe ju kemi drejtuar opinionit.

Unë kam punuar edhe privat nja 2-3 vjet, po ju them të drejtën, por nga viti 2007 nëse s'gaboju unë nuk punoj privat edhe këtë e kanë vërtetuar edhe agjencitë kundër korrupsionit dhe inspektorati i shëndetësisë dhe të tjerët dhe se kam dhënë një mendim timin i cili në atë periudhë kur është vendos për nenin e famshëm që është dërguar në Gjykatën Kushtetuese, unë kam pasur mendimin sikur që e kam edhe sot, por ne e respektojmë vendimin e Kushtetutës dhe mbi bazën e kësaj ne e kemi edhe ligjin.

E dyta, ne kemi bërë koncept dokumentin, e kemi kaluar në Qeveri dhe shumë shpejt do të ju vijë juve në Kuvend që Ligji për shëndetësi të plotësohet dhe ndryshohet në amendamentet të reja në mënyrë që ne të ecim tutje, sepse janë krijuar kushte të reja në shëndetësi dhe ajo e fundit çka nuk po dua të polemizoj shumë sepse opinionin e din, kthimi i buxhetit në shëndetësi një pjesë e buxhetit në Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht në AFSH, nuk është bërë krye në vete, si thonë ose me vetë iniciativën e ministrit dhe kabinetit të tij, por është bërë pas konsultimeve të shumta edhe kam edhe dëshmi me dokumente, takime të ndryshme me Bankën Botërore, Lluks Devën, Qeverinë zvicerane dhe me OBSH-në dhe kthimi i buxhetit në AFSH, respektivisht në Agjenci që është paraprijëse e fondeve të sigurimeve shëndetësore, krijon bazën e ecjes tutje, ndarjes së ofruesit të shërbimit shëndetësor dhe atij që blen shërbime shëndetësore.

Sot e kam pyetur me njëfarë momenti edhe ish- ministrin se a ka dalë reforma qysh keni menduar. Më ka thënë “jo”, sepse sot e kemi një centralizim ose hiper- centralizim të menaxhimit në shërbimin spitalor kliniko- universitar në një njeri dhe në një organizim i cili fare nuk jep shpresa se do të decentralizohen shërbimet shëndetësore dhe do të decentralizohet menaxhimi i sistemit tonë shëndetësor.

Pa e krijuar trekëndëshin Ministria e Shëndetësisë kontrollon AFSH, respektivisht fondi i kontraktuesi ose paguesi i shërbimit shëndetësor dhe shërbimi spitalor kliniko-univeritar bashkë me kujdesin dhe shërbimet shëndetësore, ne nuk mund të garantojmë reformim të sistemit dhe nuk kemi sigurime shëndetësore të mirëfilltë.

Kryetarja: Faleminderit! Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është duke monitoruar Ligjin për shëndetësi dhe tani jemi në një fazë mund të them nuk është në përfundim sigurisht në shtator. Ne do të japim konkluzionet para Kuvendit pas monitorimit dhe gjithashtu do ta keni të mirëseardhur besoj në ndryshim plotësimin e Ligjit për shëndetësi që është i nevojshëm, sigurisht që është i nevojshëm.

Nëse nuk ka askush kurrëgjë atëherë mund të kalojmë në pikën tjetër.

Shqip Muja: A bën kryetare se i mbeta borxh?

Kryetarja: Mirë, vetëm mos të humbim kohë se kemi një çështje shumë të rëndësishme.

Shqip Muja: Zoti ministër, unë me gjithë respektin format e thirrjes hajde shkojmë në QKUK e shohim. Unë s’kam nevojë si deputet, sepse unë s’jam ekzekutivi me shkuar, me bërë skena teatrale për paafësitë menaxherale në QKUK.

Prandaj, unë s’po të akuzoj ty se këtu janë mbledhur gjërat prej “99 e para luftës, e u pështjell lëmshi shumë, mirëpo ti modestinë me fjalë bëje me vepra, jo me forma. Prandaj, nuk ke nevojë me na qitur në opinion publik sikur ne jemi kundër aparaturave. Ne jemi për aparaturat, jemi për me i blerë aparatura. Unë një aparaturë me një çmim që mundem tri të njëjta me i blerë edhe atë praktika ka me të kallëzuar, sepse nëse zgjat ky Parlament ne kemi me kërkuar edhe auditim ekonomik të vlerës së çmimit të aparaturës.

Ju keni përshkruar këtu çmimet, por nëse janë këto aparatura që kanë me ardhur, në internet i ke çmimet e tyre. Çmimet e tyre të këtij specifikimi teknik dalin 1 milionë e 200 mijë, hapësira që ka me u renovuar më shumë se 100 mijë euro nuk shkon. Prandaj kjo a quhet kredi, a quhet hajni nuk po e di. Ne duhet t’i sqarojmë dy gjëra: mos krijo opinion publik që ne jemi kundër aparaturave. Ne jemi për me blerë aparatura. Jemi për me ble më shumë aparatura, menaxhimi i keq që rrjedh është diçka tjetër. Problemi te fondet edhe ato që ke mendimin për Ligjin e shëndetësisë. Ligjin e shëndetësisë nuk e kam rrëzuar unë, e ka rrëzuar ligji, sepse janë ligjet në fuqi. Ligjet e punës që i japin të drejtë punonjësve që janë në administratën publike edhe punonjësve civilë.

Prandaj, është i përcaktuar qartë, unë atë ligj e kam kundërshtuar në aspektin e të drejtave të njeriut. Nuk guxojmë me i cenuar të drejtat e njeriut dhe nuk guxojmë me e shkel Ligjin e punës. Prandaj, me aty kam fituar unë ka qenë edhe Qeveria kundër dhe ish- ministri ka qenë edhe Parlamenti ka qenë, mirëpo unë e kam përfaqësuar interesin e sindikatave. Unë s’kam përfaqësuar interesin tim personal. Unë kam përfaqësuar dhe kam shkuar aty si përfaqësues edhe i mendimit tim edhe të sindikatave. Prandaj e kemi fituar ne atë punë.

Në problemin e financimit që ju e keni marrë dhe mënyra unë në mandatin e kaluar organizimin shëndetësor e kam kritikuar. Nëse donë në arkiv mundesh me e pa edhe të shërbimi spitalor, edhe kam kërkuar që të specifikohet; çka ka të drejtë dhe çka ka të drejtë monitoruese shkencore ai organizim, edhe çka duhet me pas ekzekutive të përditshme edhe e di që nuk funksionon. Por për me ardhur me e rrëzuar ajo duhet me e rrëzuar Qeverinë njëherë siç nuk e ke bërë për buxhetin. Për buxhetin ke shkelje, kam thënë atëherë, po vazhdoj të të them është dashur me e anuluar vendimin e Qeverisë, me e sjell vendimin e Qeverisë të anuluar në Parlament dhe deputetët, mandej propozimin tënd me e amendamentuar në buxhet. Ti nuk e ke bërë atë premtim, ajo është shkelje ligjore.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Jo, jo unë e kam për obligim, i nderuar deputet, s'di a të kujtohet kërkesa jonë në Qeveri, nuk është bërë për kthimin e buxhetit. Edhe ajo është amendamentuar në Kuvend dhe ka kaluar dhe është bërë mirë. Ajo që keni fituar unë nuk po e komentoj absolut, sepse unë jam duke e respektuar atë ligj mirë, dhe është mirë ai ligj që është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës ku nuk ka hyrë neni i cili e keni kontestuar edhe çka ka të keqe këtu, kurr gjë.

Ligjin për shëndetësi ne do t'i marrim të gjitha vërejtjet e të gjithëve edhe besoj që edhe me Komisionin Parlamentar në takimin që kemi pasur në Ministri të Shëndetësisë jemi dakorduar që të punojmë intensivisht dhe t'i bëjmë zgjidhjet më të mira të mundshme për rrethanat ekzistuese. Këtu s'ka të keqe kurr gjë. Por, edhe unë nuk di qysh me argumentuar ndryshe sa veç me ju ftuar me shkuar bashkë edhe me pa a na kanë lajthitë ata ekspertë neve, na kanë mashtruar dhe ta shohim të vërtetën se si është gjendja. Pra, në kardiologjinë invazive, unë e di që ka nevojë, por të shkojmë bashkë të bindemi. Kurrkush nuk është duke ju thënë juve që nuk e dini ose nuk po doni, po shkojmë bashkë edhe bimë vendimin se tek e fundit këtu jemi për interesin e qytetarëve. Interesi i qytetarëve është me pasur ne shërbimin e kardiologjisë 24 orë. Ne kemi problem që besoj që ju kujtohet edhe këtu në Komision Parlamentar e kemi ngritur, por numrat të pakët të punësimit të njerëzve sidomos në këtë fazë e kemi urgjente rritjen e numrit të stafit teknik në Kardiologjinë Invazive edhe të stafit edhe të lartë edhe të mesëm në Kardiokirurgji duke u shtuar edhe nevojat e spitaleve.

Ne tash e kemi funksionalizuar e kemi lëshuar spitalin në Vushtrri, por e kemi duke e mbajtur urgjencën ose emergjencën me staf të kujdesit parësor. Krejt këto sende ne mundemi me i bërë bashkë, por kurrkush nuk është duke ju thënë juve që nuk i dini ose nuk po doni. Aparaturë ka nevojë të blihet, jo vetëm kaq, por nevojat janë vlerësuar diku rreth 30 deri në 35 milionë euro vetëm në shërbim spitalor klinik universitar në aparaturë bazike, shumicën e kemi të amortizuar edhe ju e dini që Qeveria e Kosovës ka marrë një vendim që do t'i stimulojë shërbimet 24 orësh të kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë invazive nëse funksionojnë 24 orë dhe zvogëlohen referimet në kujdesin shëndetësor privat.

Ne kemi punuar dhe do të punojmë edhe në të ardhmen që brenda Kosovës të krijojmë mundësi për qytetarët e Kosovës, qoftë publik, qoftë në privat mos të kenë nevojë ata me dalë me marrë shërbime jashtë. Sigurisht keni informata që edhe shtetet më të zhvilluara ekonomike dhe me shëndetësi shumë më të mirë janë të detyruara shpesh të blejnë shërbime jashtë vendeve të veta. Unë isha në Kroaci, Zagreb dhe e pashë që ata për kardiologji për disa raste të kardiokirurgjisë së fëmijëve blejnë shërbime Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, blenë shërbime në Linc të Austrisë.

Do të thotë edhe ne, në të ardhmen, jo vetëm tash, do të blejmë edhe shumë vjet më vonë.

- **Diskutim lidhur me punësimin e asistentëve dhe specialistëve të mjekësisë.**

Kryetarja: Ministër, çështja e dytë për të cilën ju kemi thirrur sigurisht për ju është e njohur është çështja e punësimit ose e pa punësimit të specialistëve të fushave të ndryshme e që tani është rritur numri i tyre, si dhe e asistentëve specialistë që janë të pa punë.

Kjo për neve që kemi qenë punëtorë shëndetësor ose jemi, është shumë e pakuptueshme kur e dimë sa kushton një student i mjekësisë për t'i kryer studimet. Pastaj po aq vite për ta kryer specializimin e shumica e këtyre mjekëve kanë kryer edhe sub-specializime duke qenë tërë kohën të papunë. Një pjesë e tyre kanë marrë bursa nga Ministria e Shëndetësisë dhe tani pasi i kanë kryer obligimet e tyre të shkollimit ata kanë mbetur edhe pa punë, natyrisht edhe bursa ju ndërpritet.

Të mos punosh prej vitit 2009, kemi raste të tilla, por shumica janë prej vitit 2012, 2014, 2015, dhe para meje është lista e tërë e këtyre studentëve specialistëve, është e çuditshme, sepse gjatë monitorimit të Ligjit për shëndetësi ne duke vizituar spitalet rajonale kemi parë se atyre ju mungojnë, qoftë edhe Qendrës Klinike ju mungojnë mjekët specialistë. Realisht ju mungojnë, ju mungojnë edhe teknikët si thatë, ju mungojnë shumë motrat medicinale në anën tjetër, po ndodh diçka befasuese për një shtet të varfër, po ndodh zbrazja e punëtorëve shëndetësorë.

Ne thua se kemi punëtorë shëndetësorë t'i shkollojmë, të harxhojnë mjete, mundi, të harxhojnë kohë dhe ta joshin rininë tonë të shkollohet, por në anën tjetër ata t'i dërgojmë jashtë vendit të punësohen dhe ju e dini se në kurset e gjuhëve të huaja shumica janë punëtorë shëndetësorë.

Cila është përgjigja juaj? Cila është zgjidhja për këta punëtorë shëndetësorë? A keni ndonjë planifikim se ju nuk jeni prej tani, po ua shtrojmë këtë pyetje të njoftuar për problemin, sepse sot sigurisht keni pasur edhe një protestë para ministrisë, nuk e di kështu ka qenë e paralajmëruar.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: E kemi pasur një takim miqësor.

Kryetarja: Aha, sepse në të njëjtën kohë kemi pasur edhe ne dhe para vetes kam shumë, shumë dokumente që u janë dorëzuar institucioneve shtetërore dhe institucioneve vendimmarrëse për këtë çështje.

Por, asnjë përgjigje çka do të bëhet me këtë numër kaq të madh të punëtorëve shëndetësorë, realisht të mjekëve specialistë.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së, Faleminderit, kryetare!

Më falni nëse do ta zgjas, por do të jap disa shpjegime. Para pak ditëve janë bërë një vit kur unë i kam takuar për herë të parë, do të thotë ka qenë faza e rishikimit të buxhetit për vitin 2015 dhe i kam takuar një grup të specialistëve të papunë, të cilët kanë shpreh brengën e tyre.

Më pak se tash, dhe jemi zotuar që do të angazhohemi të bëjmë zgjidhje të përkohshme derisa të krijohen mundësi që ata të sistemohen në vendet e tyre të përhershme të punës. Natyrisht që meqenëse nuk kishim një bazë të saktë të shënimeve se sa specialistë të papunë janë dhe për shkak se procesi i rishikimit të buxhetit pat hyrë në fazën përfundimtare, kur s'ka pas mundësi të shtyhet më tutje na ka mbetur pa u zgjidh ky problem me Ligjin e buxhetit, me ligjin aktual.

Tash ne më vonë kemi bërë në ueb- faqe të Ministrisë së Shëndetësisë, kemi hap një rubrikë, ku të gjithë të papunët specialistë të lajmërohen dhe të bëhet lista e saktë e të papunëve, sepse nuk kemi dashur që ne të pranojmë lista të ndryshme nga individë e cila mund të jetë edhe jo e saktë. Dhe kjo sot ne na rezulton që i kemi mbi 100 ndoshta edhe 120 mbërrin, sepse ndërkohë kanë specializuar të tjerë.

Kam pasur takime me kryeministrin, me ministrin Hoti, dhe me juve si deputetë, e ke ngritur disa herë edhe në Kuvend gjatë pyetjeve të ndryshme që na u kanë bërë, por edhe në biseda individuale, takime individuale, qoftë me profesionistë shëndetësor, me menaxher, me deputetë etj. Sot pata një takim të ri me kryeministrin dhe një takim të ri, në fakt bisedë me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Buxhet, zoti Osmani, dhe na u konfirmua që janë ndarë 300 mijë euro për këta muajt e mbetur të vitit për angazhimin e përkohshëm të specialistëve në sistemin tonë shëndetësor, që nënkupton ata do të lidhin kontratë dhe do të paguhen me pagë të mjekut specialist deri në janar.

Zotimi është që me ligjin e ri të buxhetit ku kisha dashur që ta përkrahni, të krijohen vende të reja të punës, ose të ndahen numra si të themi ne që ata t'i sistemojmë në sistemin tonë shëndetësor. Kryesisht janë specialistë të fushave klinike, por kemi të bëjmë edhe me specialistë të para klinikës dhe të stomatologjisë, këtu në këtë listë nuk hyjnë specialistët e mjekësisë familjare, sepse vetë ndarja e specializimit për mjekësi familjare është kusht që të jetë në pagë.

Nuk futen në këtë listë nuk janë as mjekët e përgjithshëm të papunë, por kryesisht janë specialistë. Shpresoj që lista është e saktë dhe shpresoj që numri nuk është shumë i madh deri në fund të korrikut dhe ky 300 mijë euro të mbulojë koston e angazhimit të këtyre mjekëve nëpër spitale dhe në klinikat e QKUK-së. Përpos përfatimit material që kanë si familje ata do të fillojnë ose do të rifillojnë të ushtrojnë profesionin e tyre, sepse pritja tre ose katër vjet nënkupton edhe degradim profesional ose humbje e aftësisë profesionale, kushtimisht të themi kështu për shkak të mos ushtrimit.

Ne do të kemi në takim me mjekët e papunë u zotuar edhe ata u pajtuan që lista do të verifikohet në ATK dhe të gjithë ata që kanë një pagë do të jenë kah fundi i listës, ndërsa përparësi do të kenë ata që nuk kanë pagë.

E dyta, si kriter i tyre do të jetë angazhimi në institucione ku ka nevojë, jo ku banojnë sikur që ka ndodhur më herët. Ai që ka jetuar në Prishtinë ka hyrë në klinikë, nuk ka qenë ndonjë kriter i madh për të hyrë në klinikë dhe do të shpërndahen nëpër shtatë spitale të përgjithshme dhe nëpër klinikat e QKUK-së. Unë uroj që me Ligjin e ri të buxhetit të jepen vendet e reja për punësimin e këtyre profesionistëve, sepse viteve tjera do ta kemi edhe më të vështirë. Unë ua jap disa shënime, këto shënime do t'ua lë zonja kryetare.

Në vitin 2016 besoj që disa kanë diplomuar ose kanë specializuar, fitojnë të drejtën të hyjnë në provim specialistik 144 doktorë. Vitin 2017 fitojnë të drejtën me hy ose diplomojnë, specializojnë 194 tjerë, vitin 2018 specializojnë 141 të tjerë, në vitin 2019 210 dhe në vitin 2020 25. Që do të thotë deri në fund të vitit 2020 ne do t'i kemi, përjashtoj këta që sot i kemi pa punë, plus 714 specialistë. Nga ana tjetër nga një analizë që e kemi bërë del që në kujdesin parësor shëndetësor janë 101 mjekë mbi moshën 60 vjeçare, në shërbim spitalor klinik universitar janë 151 mbi moshën 60 vjeçare, që nënkupton deri në fund të vitit 2020 nëse presim lirin e vendeve dhe futjen e të rinjve mund t'i punësojmë vetëm 252.

Në anën tjetër në drejtim të zgjidhjes ose zbutjes së këtij problemi ne kemi marrë edhe një iniciativë dhe takimi i parë veç është mbajtur, kemi formuar një komision tri palësh: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Universiteti i Prishtinës. Qëllimi kryesor është unifikimi i pagës për profesorët e Fakultetit të Mjekësisë, që nënkupton ata të punojnë edhe në proces mësimor edhe në klinikë, por ta kenë një pagë dinjitoze të profesorit ose të profesionistit me angazhim akademik. Kjo nënkupton që mund të lirohen edhe mbi rreth 200-250 vende të reja të punës, të cilat tash figurojnë të mbyllura për shkak se profesorët tonë edhe asistentët kanë një pagë në Fakultet të Mjekësisë dhe një pagë sekondare kanë klinikat e QKUK-së.

Do të thotë, problemi i specialistëve të papunë që deri sot janë të paraqitur ose që kanë diplomuar me njëfarë mënyre ka marrë zgjidhje, por është zgjidhje për këtë kontingjentin, por çka do tu bëjmë neve 715 të tjerëve që deri në vitin 2020 do të specializojnë plus, po ju informoj që pas stabilizimit të rrethanave në sektorin e specializimeve, sepse aty ka qenë një kaos i vërtetë. Ne kemi arritur që të lirojmë mundësinë e dhënies së rreth 70 specializimeve numri mund të jetë edhe mbi 70, sepse pritet deri në fund të tetorit të specializojnë edhe disa, dhe të shpallim një konkurs të ri për specializimet e reja.

Plus, do të shpallet një numër shumë më i madh i specializimeve edhe në mjekësi familjare, sepse kemi vlerësuar nevojat dhe kemi parë që disa nga komunat kanë nevojë shumë të madhe për këto specializime. Këto specializime do të jenë me pagesë, do të thotë ne me stabilizimin e këtij sektori me politikat tona kemi arritur t'i lirojmë këto vende. Por, specializimet do të jenë vetëm mbi bazën e nevojave që i kemi vlerësuar për spitalet e përgjithshme dhe për klinikat e QKUK-së. Faleminderit!

Kryetarja: Ju thatë se këta specialistë do të shpërndahen në spitalet rajonale dhe klinika, kush do t'i shpërndajë Ministria, drejtori i QKUK-së, apo është domethënë institucioni i shpërndarjes po më intereson.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Ne kemi bërë një data bazë të specialistëve që i kemi në institucionet tona shëndetësore, duke filluar prej profilit të specializimit, prej vendit të punës ku punon në cilën klinikë, në cilin spital, në cilin repart dhe moshën, cila është mosha e tyre dhe kur pritet ata për shembull me dal në pension.

Natyrisht, që bashkarish me përgjegjësit e shërbimit spitalor klinik universitar Ministria e Shëndetësisë do të bëjë hartimin ose përpilimin e nevojave fillimisht të spitaleve të përgjithshme e më vonë edhe të klinikave të QKUK-së. Nuk do të ketë mundësi që disa t'i sistemojmë në spitalet e përgjithshme nëse e kanë profilin specialistik terciar. Për shembull: kirurgji plastike, kirurg dhe ngjashëm, neurokirurg, ata detyrimisht do t'i sistemojmë në klinikat përkatëse në QKUK.

Kirurgët e përgjithshëm, internistët dhe profilet të tjera të cilat mund të japin shërbime në spitalet e përgjithshme dhe paraqitet nevoja në spitale të përgjithshme për ato profile, ne do t'i orientojmë atje, sepse vetëm kështu mund të japim shërbime shëndetësore të mjaftueshme dhe t'i plotësojmë nevojat.

Kryetarja: Faleminderit! Urdhëro, ndoshta kanë edhe kolegët diçka.

Shaip Muja: Unë kur i thashë ministrit se është keq me thënë kam trashëguar keq situatën, po mundohem me e rregulluar. Këtu po flasim për dy kategori, një kategori e ke, e cila unë për vete ndihem i turpëruar edhe si deputet, edhe si strukturë e shtetit kur specialistët i shohim në rrugë dyfish, njëkohësisht si shtet që nuk po ju gjejmë mundësi me i sistemuar, edhe e dyta, si kolegë e sheh një koleg duke demonstruar, thotë më jep punë. Por, e ke edhe një kategori tjetër që është duke u specializuar, e nuk është duke u paguar, e është edhe më e madhe se kjo që po demonstroi, a po?

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Jo, krejt janë këtu, me pagesë, pa pagesë, krejt janë këta.

Shaip Muja: Janë në specializim, janë duke specializuar pa pagesë, me vetëfinancim. Format se si kanë bërë kjo është përgjegjësi e shtetit, edhe ajo forma me vetëfinancim është gabim. Unë i kam adresuar gabimet vazhdimisht, ajo është bërë gabim.

Ministër, unë po ju pyes a keni ju informacion sa mjek, përveç atyre që do të dalin në pension kanë emigruar si staf i mesëm edhe i lartë në botën e jashtme. Këto dy vjetët e fundit, a ke informacion sa veta? Unë po ju tregoj për Gjilan nga je ti më së paku nja 20-30 specialistë janë duke e mësuar gjuhën gjermane, ti e din, 30 specialistë, pa infermierë, nëse ikin këta 30 në kolaps bie Qendra Spitalore e Gjilanit.

Prandaj, analizat edhe një diçka e bazuar a i ke të sistematizuar në vendet e punës sipas standardeve që i përshkruan Organizata Botërore e Shëndetësisë nga stafi i mesëm deri te stafi i lartë. A i plotëson Kosova me standardet? Na duhet me thënë haptazi jo, ne kemi nevojë ende me punësuar mjek, sepse ata që na i formojnë politikat e punësimit, ata s'kanë haber me shëndetësi, as me planifikim shëndetësor dhe ministrat dorëzohen edhe thonë “ mirë, s'po na i lejojnë, kaq na kanë lejuar neve”. Mirëpo, nëse llogaritet sot, takova një patolog, nëse spitali në Vushtrri i kushton kostoja një mjekut 2 mijë euro patolog në laboratorin e tij në vit është 24 mijë dhe ai shpëton dhjetë veta mos me të hy ty në sistem të referimit me ia paguar për jashtë me shkuar nga diagonalistikimi i hershëm që i bëhet dhe 10 veta hipotetizohet po themi nga 5 mijë euro minimalisht u jepni, janë 50 mijë euro.

Do të thotë, 50% e ka ruajtur buxhetin mos me shkuar jashtë, se kur po mbesin në fazë terminale pacientët po mbesin vetëm në zyrat e QKUK-së dhe zyrat e tua. Prandaj, ne duhet të flasim në atë mënyrë. Tjetra, sistemi primar është i pambuluar në Republikën e Kosovës edhe jeni përgjegjës ju, sepse jeni monitoruesi i politikave që i keni prodhuar vetë. Prandaj, ne çka të kesh ti nevojë në nivel të përmbajtur statistikor shkencor e ke votën tonë, për vota me hatër, për këto mos ia mësyni kurrë njëherë se s'keni me marrë votën.

Po është e bazuar, ftoni edhe 100 vetë, edhe 200 vetë të punësohen, ta bazojmë, ta arsyetojmë sepse politikanët ne nuk mundemi me i bindur se ka nevojë sistemi shëndetësor për kuadro, e mandej kryeni punën ju duke i monitoruar ata kuadro po e kryejnë punën e vet.

Kryetarja: Ministër unë e kam edhe personalisht një pyetje, si mundet me u zgjedh një asistent nëse ai është i papunë?

Ai kurrë praktikën s'e ka prekur me dorë, si mundet me iu përcjell kolegëve të vetë një praktikë?

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Së pari, shumë e thjeshtë është kjo, Ministria e Arsimit është kompetencë e saj që kur bëjnë kontrata me asistentë. Më vjen mirë që deputeti Muja tha që kemi trashëguar shumë probleme dhe ne po mundohemi t'i zgjedhim.

Është e vërtetë, çdo punë po i hyjmë nga baza, ka ekzistuar dhe besoj që pajtoheni që ekziston sot një ndarje jo normale mes Fakultetit të Mjekësisë dhe Klinikave të QKUK-së dhe kjo duhet të vendoset në baza të tjera, dhe të kemi një lloj koordinimi më të mirë mes nevojave të klinikave dhe sistemit tonë shëndetësor dhe të shpalljes ose të regjistrimit të studentëve. Se si rezultat i një mos planifikimi të tillë para shumë viteve ka ndodhur që prej vlerësimeve, për shembull 100-150 studentë ka arritur shifra 300-400 dhe kur ata kanë hyrë në Fakultet të Mjekësisë natyrisht që me punën e tyre dhe angazhimin e kanë përfunduar fakultetin dhe ata të gjithë kanë bërë presion se është e drejtë e tyre qoftë fillimisht të punësohen më vonë edhe të vazhdojnë shkollimin specialistik, respektivisht marrjes së specializimit.

Ju e dini që në të kaluarën e afërt është bërë ndarja e specializimeve sipas shumë kriterëve, një kriter që është kjo, në fakt një grup ku Ministria e Shëndetësisë i paguan edhe i ka me sa di unë diku 300-302 vende i ka pas fillimisht të mundshme për me i nda specializimet dhe me i paguar, është

zvogëluar ajo shifër nga një vendim që i ka punësuar 24 specialistë në QKUK dhe ende paguhen nga Ministria e Shëndetësisë.

Ata, ka 4-5 vjet, nëse s'gabo, që punojnë në klinikat e QKUK-së dhe paguhen nga Ministria e Shëndetësisë, një. E dyta, është bërë ndarja e specializimeve me vetëfinancim. Fillimisht një numër i caktuar, më vonë kur presioni ka qenë i tillë edhe i madh sigurisht se përndryshe nuk ishin bërë këto veprime, janë ndarë specializime të ashtuquajtur të grupit “B” me një vërtetim nga spitalet e përgjithshme dhe eventualisht klinikat diku-diku, kinse për nevojën për atë lloj profili të specializimit dhe mbi bazën e këtij, kjo grup sot i ka 350 specializantë në sistem mbi bazën e atyre vërtetimeve që janë ndarë nga spitalet dhe është edhe një grup tjetër, grupi “C” që ka marrë vërtetime nga sektori privat për nevojën e sektorit privat për atë lloj të specializimeve dhe krejt kjo ka rezultuar që në fund të vitit 2014 në fillim të vitit 2015 me mundin më të madh mezi i kemi mbledhur për shkak të rrethanave tilla që ekzistojnë ka dalë afër 1 mijë specializantë, 997 specializantë në sistem.

Dhe përpos pamundësisë me i paguar të gjithë këta aty ka ardhur një diçka tjetër që ne duhet ta themi, sa ka mundësi sistemi jonë shëndetësor me i specializuar në mënyrë kualitative ose ata specializantë me i arritur objektivat e aftësisht profesional mjaftueshëm në këto rrethana, kur numri është kaq i madh edhe kjo është për t'u vlerësuar dhe për tu analizuar dhe krejt këto kanë bërë që ne të kemi një kujdes të veçantë për fushën e specializimeve dhe vitin e kaluar ne nuk kemi shpallur konkurs të specializimeve, sepse kemi menduar në këtë të rregullojmë situatën çfarë e kemi gjetur.

Kah mesi i vitit 2014 është shpall një konkurs i rregullt, respektivisht një konkurs për dhënien e specializimeve me pagesë dhe janë dhënë 67 specializime. Vetëm 37 kanë arritur në atë fazë që të futen në listë të pagave, sepse kaq ka pasur vende dhe 30 të tjerë kanë mbetur në të ashtuquajturën pagesë nga subvencionet ose performancat. Dhe, me diplomimin ndaj tyre kemi pas obligime ligjore me i fut në listë të pagave nga fillimi dhe prej fillimit të marrjes së mandatit ne kemi pasur kujdes që ta përcjellim listën e të specializuarve dhe në çdo moment kur është liruar një vend në listë pagave për specializime ne e kemi futur at të parin që ka qenë në radhë duke pritur ose që ka qenë duke u paguar nga subvencionet dhe e kemi stabilizuar këtë segment, do të thotë i kemi të gjithë në listë të pagave.

Në anën tjetër ka qenë shifra 264, nëse nuk i kam harruar që një vjet e specializantëve të paguar nga performansa, nga fondi, buxheti për subvencione respektivisht performanca. Dhe ne e kemi bllokuar mundësinë që dikush të futet në atë listë me specializimin e një specializanti që ka qenë brenda listës dhe ajo listë është duke u zvogëluar në vazhdimësi.

Në anën tjetër, falë auditorit, ne kemi zbuluar që disa nga këta kanë marrë paga edhe të tjera ose janë paguar diku dhe ne në momentin që e kemi argumentuar një numër i kemi gjetur me emër dhe mbiemër ne kemi ndërprerë pagesën nga subvencionimi, sepse kanë pasur një kontratë ku ata kanë garantuar se nuk kanë pagë tjetër. Ka indikacione që kjo shifër është më e madhe, në momentin që ne ta vërtetojmë do ta nxjerrim edhe ata do t'i nxjerrim nga sistemi, është fatkeqësi e madhe që ne nuk kemi mundësi t'i mbulojmë 350 specializantë plus ata të grupit “C”, me buxhetin ekzistues për me i paguar.

Por, përpos asaj kolegiales, njerëzores edhe humanitares Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndonjë farë obligimi ligjor mu brengos shumë, sepse kanë një kontratë ku saktë specifikohet që ne do të vazhdojmë specializimin, por heqim dorë nga pagesa. Mua më vjen keq sot me ma ndarë buxhetin. Unë sot i futi në listë të pagave edhe sot fillojë me ua dhënë pagesën.

Një problematik tjetër që është ngritur më vonë, në fillim të këtij viti, ka qenë pagesa e kujdestarive. Vitin e kaluar janë paguar nga SHSKUK, këtë vit kinse për mungesë të buxhetit nuk është bërë pagesa e kujdestarive prej janarit dhe ne në Ministri të Shëndetësisë duke e analizuar kontratat ekzistuese dhe ligjet në fuqi kemi marrë vendim që meqenëse ata janë në proces edukativ t'ju paguajmë kujdestaritë e rregullta ditëve të punës. Ndërsa, nëse shërbimet spitalore klinik universitar i Kosovës ka nevojë për angazhim të tyre në festa dhe në ditë vikendi e merr përsipër pagesën e kujdestarive për ata specializantë.

Duhet të themi këtu që është rregulluar një çështje, sepse aty ka pasur raste kur një specializantë ka pasur 4 kujdestari, 5 kujdestari në muajt, ju kanë paguar veç dy edhe kanë pasur, kanë pranuar specializantë, të cilët janë ankuar se ka favorizime të individëve të caktuar në krijimin e orarit të kujdestarive, në bërjen e orarit të kujdestarive, sepse një kujdestari të shtunën ju e dini që paguhet 24 orë komplet a kujdestaritë të premtën dhe të dielën paguhet 16, ndërsa ditëve të punës paguhet 8 dhe mu për këtë kemi marrë vendimin e tillë.

Edhe diçka që kemi dashur ta stabilizojmë ose ta vendosim në rrugë të drejtë procesin e specializimeve është nxjerrja e vendimeve që ndalon, ndërpret mundësinë e ndërrimit të specializimeve në faza të ndryshme të specializimit. Ju e dini që ka qenë praktikë bukur e shpeshtë që doktorët në specializim me ndërruar specializimin në vitin e dytë e të tretë e disa edhe nga dy herë e kanë ndërruar. E kemi marr atë vendim fillimisht që të ndërpritet pa kushte, më vonë e kemi nxjerrë vendimin që janë disa kushte që prapë lejojnë ndërrimin e specializimit, por jo pa kushte. Faleminderit!

Kryetarja: Faleminderit! A ka dikush tjetër prej kolegëve?

Hatim Baxhaku, Faleminderit, kryetare!

Desha vetëm shkurt, siç tha kryetarja ne jemi duke i vizituar qendrat spitalore, spitalin e përgjithshëm dhe kemi vërejtur se disa spitale nuk kanë patolog, nuk kanë biokimist, punojnë pa ata, a është obliguese?

Kështu që më vjen mirë që e keni marrë këtë vendim që deri në fund të vitit me gjetur një zgjidhje për pagesë. Por mendoj që në qoftë se hulumtohen më mirë të gjitha spitalet sigurisht që ka vende të lira diku, sepse një spital nuk mundet të funksionojë laboratorit pa biokimist, ndërsa në listë pashë që kishte biokimist të papunë, patolog do të thotë për një numër sigurisht do të gjendet mundësia më lehtë, për një numër pak më vështirë, por sidoqoftë unë ju përkrah dhe ju përgëzoj për këtë nismë. Nuk e kam të qartë ende sa është numri i specializantëve me vetëfinancim që janë deklaruar.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: 350 veta.

Hatim Baxhaku: Faleminderit! Edhe sa janë të tjerë që s'paguhet, por që kanë filluar?

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Këta janë që s'paguhet, ka qenë 260 ka mbetur diku 150-160 veta, më shumë s'janë sepse ata janë në proces.

Mbi 500 janë me i marr të gjithë, jo paguhet nga performanca, por nëse ne, dëgjo, ata marrin subvencione, ajo është një lloj burse, një lloj përkrahje materiale që nuk evidentohet kurrkund, nuk tatimohet, nuk evidentohet në ... dhe ata nëse duan me shkuar me marrë kredi nuk mundet ta dëshmojnë se janë në pagë.

Hatim Baxhaku: Faleminderit! Unë do të ju kisha lutur për këta që janë me vetëfinancim me gjetur një zgjidhje, në qoftë se mundet, nuk është në duart e juaja e di që është diku të buxheti, por ata kanë qenë në lajthitje. Unë mendoj që ata janë mashtruar pak edhe nuk është bërë mirë me atë grup, nuk jeni ju për këtë çështje përgjegjës, por me të vërtetë nuk ka qenë mirë që janë lajthitë dhe janë sjellë në atë situatë. Faleminderit!

Bekim Haxhiu: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Është shqetësuese që të shohësh kolegët specialistë të mjekësisë së fushave të ndryshme të protestojnë për vende të punës.

Ne njëkohësisht kemi spitale rajonale që kanë mungesa të specialistëve, ndërsa kemi specialistë që protestojnë për të hyrë në punë. Kjo dëshmon në atë që e kam thënë me vite që ne kemi një keq menaxhim human në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për vite, jo vetëm te ministri aktual, por edhe te ministrat paraprak të cilët kanë bërë një keq menaxhim human.

Situatën çfarë sot ndodhemi është si pasojë e mos gatishmërisë së ministrave që të menaxhojnë me kapacitetet humane në mënyrë profesionale sipas standardit të Organizatës Botërore të Shëndetit. Prandaj kemi ardhur në këtë situatë ku specialistët protestojnë, ndërsa në Mitrovicë kemi mungesë të specialistëve, në Prizren kemi mungesë të specialistëve dhe në Pejë kemi mungesë të specialistëve, ndërsa në Qendrën Klinike Universitare kemi mbingarkesë të specialistëve.

Ne kemi klinika në QKUK që paguajnë një mjek për një pacient, ose paguajnë një mjek për shembull po e marr shembull ... vaskulare kemi 9 mjekë dhe kemi 20 shtretër, do të thotë përafërsisht paguajmë 1 mjek për 2 shtretër, ndërsa lista e pritjes së pacientëve vaskulare është tri vjet. Tri vjet duhesh me prituri ti për me hy në rend për operim në vaskulare, ndërsa paguajmë 9 mjekë dhe këtu kemi një keq menaxhim total që Ministria asnjëherë nuk ka pasur gatishmërinë, asnjë ministër me vendos dorën mbi këtë çështje me thënë se kështu janë standardet për menaxhimin human, këto standarde duhet të implementohen.

Jo, zgjidhje e përkohshme për specializim. Ne duhet të shohim zgjidhje afatgjate jo vetëm për këta specialistë që po protestojnë sot. Ne duhet të kemi zgjidhje afatgjate për specialistët që janë sot në punë edhe për kolegët që përfundojnë Fakultetin e Mjekësisë për arsye se ne kemi një evazion të këtyre kuadrove jashtë vendit. Po na ikin përditë, ne kemi marrë një situatë që pas pesë vjetëve s'kemi ku me dërguar fëmijën tënd te mjeku, për arsye se kuadro më të mira kanë me ikur jashtë vendit dhe ti nuk ke mundësi me e mbrojtur me formën adekuate të menaxhimit human.

Dhe kjo është për shkak se asnjëherë ministria s'ka pasur gatishmërinë me e vendos dorën mbi menaxhimin human në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

E nderuara kolege kryetare, këtu jemi të barabartë, ju lutem të keni durimin se kemi ardhur të diskutojmë, çështje e vetmja, dallim në mes meje dhe Shqipërisë është sot këtu që s'marrim mëditje ... kolegët tjerë dhe këtu jemi të barabartë, por jemi për interes shumë më të madh të kolegëve deputetë.

I nderuar ministër, besoj që këto të dhëna i keni edhe ju, kur i kemi edhe ne si deputetë. Besoj që edhe ju i keni dhe vërtetë do vendosni gatishmërinë, guximin dhe dijen me vendos dorë mbi menaxhimin human se është përgjegjësi ligjore e juaja. Nuk është ashtu si e thatë ju, është obligim ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ajo forma që po planifikoni me ia rregulluar në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë për t'i liruar disa vende të punës për shkak të profesorëve me bërë, e keni

propozimin e amendamentit tim në Ligjin e shëndetësisë me këtë komision që e kanë bërë në kohën kur ministri Agani ka përgatitur ligjin e ri të shëndetësisë.

Atëherë kam projektuar dhe propozuar që kjo formë të zgjidhet në atë formë që profesorët të kenë një pagë dhe ata të cilët janë në kuadër të procesit mësimor, të kenë një pagë në kuadër të buxhetit të konsoliduar të Kosovës në bazë të kategorizimit të përgatitjes së tyre profesionale, por edhe të arritjeve të tyre akademike. Është refuzuar nga ministri aktual, po në një situatë që gradualisht ju po tentoni me e zgjidhur, nuk po arrini ta zgjidhni, por jemi vendi i vetëm që kemi specialistët që protestojnë, ndërsa Evropa ka mungesë të specialistëve dhe i fton ata përditë atje.

Po, e nderuara kryetare, nëse më lejohet krejt për fund, i nderuari ministër, këtu edhe njëherë se kisha një dilemë a e kam lexuar mirë apo jo, marrëveshjen në kuadër të marrëveshjes të planifikohet dërgimi i katër personave që të shkojnë në trajnim në Vjenë për 14 ditë me 10 ditë pune atje. Këto domethënë në kuadër të atij çmimit prej 2 milionë e 100 mijë euro. Ndërrojeni çmimin e marrëveshjes bile 2 milionë e 100 mijë euro qysh e keni, hajde votojmë nuk e bie me këtë shumën prej 2 milionë e 600 mijë euro, nuk kalon në Kuvend se nuk ka as procedurë të tenderimit edhe është keq menaxhim apo mos me thënë më keq se është një vjedhje klasike. Ndoshta për kolegët deputetë s'janë kurrgjë, por për qytetarët janë shumë.

Kryetarja: Meqenëse jemi në fazën e monitorimit të Ligjit për shëndetësi edhe duke e analizuar këtë listën e specialistëve, shohim se shumica e tyre janë nga Prishtina. Pikërisht për shkak ndoshta edhe të mungesës së spitalit, do të thotë në Prishtinë përgjithshëm, sepse një pjesë e madhe e tyre do të mund të punësoheshin aty, aq më tepër që shërbimi primar, domethënë mjekësia familjare sot s'ka specialistë në kuadër të organizimit të vet.

Në të gjitha rastet dërgohen tani në klinikë ose dërgohen në shërbime spitalore. Edhe kjo çështje ndoshta është një çështje për t'u diskutuar, sepse në këtë moment po më kujtohet vetëm Shtëpia e Shëndetit në Prishtinë sa specialistë ka pasur: pediatër, internist, radiolog, patolog, mjekësi e punës e tjera, e tjera. Të gjithë këta nuk kishin qenë në këtë listë. Urdhëro, bëjeni edhe ju pyetjen.

Shaip Muja: Një plotësim mendoj, çështjet të personeli në QKUK edhe forma se si duhet të gjendet mënyra e pedagogëve që janë edhe pedagogë edhe mjek të përditshëm është Ligji i punës i cili e obligon pagën primare dhe pagën sekondare që i deklarojnë ata. Unë mendoj që ky është problem multidiciplinar e kam thënë në dhjetor të vitit të kaluar, ju kujtohet ndoshta kur kemi thënë se duhet me ulur disa ministri, jo vetëm ju vetë, dhe më diskutuar këtë çështje.

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: E kemi formuar komisionin me Ministrinë e Arsimit dhe Universitetin.

Shaip Muja: Ministria e Arsimit, Universiteti, Ministria e Financave duhet me u ulur bashkërisht për me mundur me e marr atë platformë, çka nuk është zgjedhje 200 mësimdhënës me ua ndal atë financim, po problemi është te mësimdhënësit, zoti Imet. Ti e ke kryer vetë specializimin këtu, duhet me shkuar me pa cilat janë protokollat e edukimit, çka ka prodhuar Ministria e Arsimit, çka ka prodhuar Ministria e Shëndetësisë, protokollat janë, programet.

Prandaj, nëse nuk plotësohen ato se ajo është një blerje e shërbimit prej Ministrisë së Arsimit, prandaj mos u merrni se nuk është zgjedhje ajo punë. Zgjedhja më e mira është mjekësia e bazuar në evidencë edhe këta ndërkombëtarët të cilët vijnë këtu e thonë “medicine based evidence”. E

bazuar në evidencë është për personelin, për shërbimet, për planifikimin. Unë e shoh për shembull edhe politikat e juaja edhe Feridit krejt u mbyttë duke ndërtuar. Unë i quaj menaxherë të tullave. Organizata Botërore e Shëndetësisë, në vitin 2009, e ka dhënë një vlerësim që 45% e hapësirat të QKUK-së janë të pashfrytëzueshme, dhe ne ndërtojmë ende objekte ekstra.

Në vend që të planifikojmë qysh e tek ato ekzistueset, ne planifikojmë ende dhe nuk e bëjmë mend që ato do të jenë nesër rëndim i buxhetit. Jo vetëm ti, si ministër, por të gjithë ministrat. Prandaj është mirë me mundur edhe me komisionin edhe me parë edhe problemin e asistentëve. Asistentët janë trashëguar prej paraluftës. Profesorët e famshëm i kanë gjetur fëmijët e vet, ju kanë thënë për me ua rregulluar notat, e dimë ne, e din ti, kanë thënë si student ka filluar ai asistent se është, por mandej e ka marrë Enver baba e ka implementuar në status të universitetit edhe kjo është trashëguar.

Kryetarja: Faleminderit! Urdhëro, ministër!

Imet Rrahmani, ministër i MSH-së: Unë pajtohem plotësisht që duhet ne të shikojmë se sa i kemi programet specialistike në nivel dhe shkollimi specialistik a është adekuat konform thirrjeve që marrim në fund specialistët.

Unë ju them që këto ditë i vetmi program specialistik i akredituar ndërkombëtarisht është programi i shkollimit specialistik për mjekësi familjare dhe ka qenë vitin e kaluar tash e kam marrë konfirmimin javën që shkoi dhe të premten do ta kemi solemnisht lansimin. Edhe për tri vjetët e ardhshme akreditimin nga Kolegji Mbretëror i mjekëve të përgjithshëm të Britanisë. Që do të thotë që mjekësia familjare duhet të përkrahet dhe jemi duke e përkrahur. Mirëpo, për herë të parë, e kemi kthyer vëmendjen kah kujdesi parësor edhe, ata kanë qenë, po ne s'kemi qenë të fokusuar në mjekësi familjare si politik dhe si politik bërje në përkrahjen e kujdesit parësor shëndetësor dhe mu për këtë prej fillimit të mandatit e kemi një qasje krejt ndryshe dhe një përkujdes më të madh për kujdesin parësor shëndetësor dhe po vlerësojmë gjithmonë mundësitë e përkrahjes, sepse pretendohet dhe kështu duhet të jetë në të ardhmen që 80% e shërbimeve përafërsisht të nevojshme për pacientët tanë të merren mu në kujdesin parësor shëndetësor dhe mjekësia familjare implementimi i konceptit të mjekësisë familjare mund të bëhet vetëm me përkrahjen e të gjithëve dhe kemi vlerësuar tash këtë fazë, përpos nxjerrjes së disa dokumenteve edhe udhëzimit administrativ edhe statuteve unike ne kemi vlerësuar edhe nevojat për mjek familjar.

Dhe mu për këtë arsye këtë vit do të kemi pak më shumë, sepse ka komuna që i kanë plotësuar nevojën bazë të standardeve, por ka komuna që janë shumë mbrapa.

Dhe mu për këtë ne po themi jemi duke u munduar që ta përkrahim.

Mirë, mirë krejt në këtë unë s'po hy në detaje se po i shoh që edhe disa nga deputetët u lodhën. Unë s'po i them kurrkujt s'i kuptojnë. Unë nuk po dua të hy shumë në detaje, sepse me projektin e Bankës Botërore ajo pagesa për kapitacion bazuar në performancë parasheh mu këtë kriteret ose ato indikatorët që do të vlerësojë në të ardhmen fondi e në këtë fazë projekti i Bankës Botërore për pagesë të komunave janë mu këto mbulimi hapësinor, mbulimi kohor, evidentimi i çdo qytetari, respektivisht lidhja me mjekun, çdo qytetar me pasur mjekun e vet, të gjitha këto kanë me qenë indikatorë të matshëm që me mundur me marrë ata pagesën nga performanca.

Kjo që janë shumica të Prishtinës, ju besoni që pajtoheni. Besoj që pajtoheni që mungesa e një spitali të përgjithshëm për Prishtinë e ngarkon QKUK-në. Dhe besoj që edhe pajtoheni që janë këto efekte domino se nëse është ndarë specializim për kirurgji plastike. Unë s'di ku ki me çuar tjetër kund jashtë se në klinikën e kirurgjisë plastike. Unë pashë këtu nja 2-3 që janë kirurgë plastikë dhe mu për këtë në këtë vit do të shpallim konkurse, ndoshta jo qind për qind saktësisht të vlerësuar, por 90% sigurisht janë vetëm për pozita ose profile që mungojnë në sistemin tonë shëndetësor.

Nuk do të jenë shumë më mjekët e rinj që duan të specializohen, por ato janë nevojat tash të sistemit tonë shëndetësor dhe ju besoj që edhe këtu pajtoheni që shumë herë ka pasur konkurse që me kontratë janë lidhur specialistët për obligimin e tyre që pas specializimit të kthehen të punojnë në spitale të caktuara dhe kjo asnjëherë s'ka ndodhur. Pse s'ka ndodh, unë nuk mund ta di. Ndoshta unë e di, por meqenëse s'kam argumente nuk dua ta them.

Kryetarja: Ju faleminderit për kohën që keni gjetur, për shpjegimet. Ju faleminderit gjithë stafit!

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 22.06.2016

Kryetarja: Atëherë pika tre dhe katër do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës. Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA